



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

**01/ N.110 /2011**

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës 03/L-040 neni 40, Rregulloren për zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim Nr.02/2010, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 32.2. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë: 26.09.2011 mori:

## **VENDIM**

**PËR**

**THEMELIMIN E ZYRËS PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

**I**

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 01Nr.110 të datës 20.09.2011 për themelimin e zyrës për Komunitete dhe Kthim e cila do të promovon, identifikon, përkrahë dhe mbikëqyr politikat aktivitetet dhe programet përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, krijimin e kushteve për kthimin e qëndrueshëm të komuniteteve, të kthyerve, personave të zhvendosurve dhe atyre të riatdhesuar.

**II**

Detyrat e kësaj zyre do të jenë në përputhje të plotë me rregulloren për zyret për komunitete dhe kthim me numër Nr.02/2010 të miratuar me datën 12.08.2010 nga Qeveria e Kosovës.

**III**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit

**IV**

Me këtë vendim njoftohen: Zyra e Kryeministrit, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 26.09.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Menduh Vlasi

